



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 958/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit Av.L.V., avokat nga Prishtina, me seli te rruga “...” Kompleksi ..., Hyrja ... kati përdhësë, numër 1, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.B., avokate nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Fushë Kosovës, me seli në rrugën “Tahir Zemaj” numër 2, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.299/23 të datës 15.05.2023 të Përmbartuesit Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, jashtë seancës, me datën 15.12.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. HUDHET SI I PA AFAT prapësimi i debitorit Komuna e Fushë Kosovës, ndërsa Urdhri P.nr.299/23 i datës 15.05.2023 i nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.299/23 të datës 15.05.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor-titullit ekzekutiv Marrëveshja e Ndërmjetësimit nr.036/2022 e datës 27.12.2022, duke e urdhëruar debitorin që në emër të detyrimit në të holla, t’ia paguajë kreditorit shumën prej 312.00 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Debitori ka paraqitur prapësim ndaj urdhrin përmbartimor të lartcekur.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm për arsyet si në vijim:

Sipas vlerësimit të gjykatës, debitori Urdhrin Përmbarrimor P.nr.299/23 të datës 15.05.2023, të lejuar nga Përmbarruesi Privat Blerim Baloku, e ka pranuar me datë 18.05.2023, e cila vërtetohet nga fletëdërgesa për dorëzim personal e Përmbarruesit Privat që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është dorëzuar me datën 26.05.2023, e cila vërtetohet nga vula e pranimi të Përmbarruesit Privat që gjendet në shkresat e lëndës.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore përcaktohet se *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimi të vendimit përmbarrues ose urdhrin përmbarrues”*, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se *“Në qoftë se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.”*

Andaj, duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori Urdhrin Përmbarrimor P.nr.299/23 të datës 15.05.2023, e ka pranuar me datën 18.05.2023, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimi ka filluar të rrjedhë nga data 19.05.2023, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimi ka qenë data 25.05.2023, por debitori prapësimin e ka dorëzuar tek Përmbarruesi Privat me datën 26.05.2023, dhe nga kjo rezulton se prapësimi është dorëzuar 1 (një) ditë me vonesë.

Rrjedhimisht, meqenëse është konstatuar pasafatshmëria, gjykata nuk është lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve të tjera të parashtruara nga debitori dhe në bazë të nenit 73 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.958/23, me datë 15.12.2023

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.